



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2020:038892
Datë: 20.02.2025
Numri i dokumentit: 06877071

Rev.nr.452/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Lumni Sallauka, kryetar, Zenel Leku dhe Milena Deric, anëtar, në çështjen juridike të paditësve T. B., F. B., të miturve A. B., E. B. dhe V. B., të përfaqësuar nga prindi i tyre F. B., Xh. B. dhe A. B., të gjithë nga K., rr. “D. B.”, nr., të cilët sipas autorizimit i përfaqësojnë Lule Bilalli dhe Jeton Idrizi, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Sh.a., në Prishtinë, rr.“Nëna Terezë”, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Sh. T., dhe të paditurës NPTSH Buebari Comerc - Petrol, me numër të biznesit ..., me pronar N. G. nga K., me objekt kontesti kompensim dëmi material dhe jo material, vlera e kontestit 119,997.00 €, duke vendosur sipas revizionit të paditurës, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.211/21, të datës 12.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.02.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet pjesërisht i themeltë revizioni i të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Sh.a, me seli në Prishtinë, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.211/21, i datës 12.02.2024, në pikën I të dispozitivit, lidhur me kompensimin e dëmit jo material në emër të dhimbjeve fizike dhe frikës, ku tani gjykohet si në vijim: Detyrohet e paditura Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Sh.a, me seli në Prishtinë, që paditësit T. B. nga K., për kompensimin e dëmit jo material në emër të dhimbjeve fizike, t’ia paguaj shumën prej 7000,00 €, si dhe në emër të frikës, t’ia paguaj shumën prej 7000,00 €, me kamatë ligjore prej 8%, e cila llogaritet nga dita e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë e deri në pagesën definitive.

II. Refuzohen të pathemeltë revizioni i të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Sh.a, me seli në Prishtinë dhe revizioni i paditësve T. B., F. B., A. B., E. B., V. B., Xh. B. dhe A. B., të gjithë nga K., në pjesën tjetër ndaj aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.211/2021, të datës 12.02.2024.

III. Mbetet e pashqyrtuar pika V, e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.211/2021, të datës 12.02.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3043/2014, të datës 21.10.2020, në pikën I (një) të dispozitivit është: “Aprovuar pjesërisht si e bazuar kërkesëpadina e paditëseve T. B., F. B., A. B., E. B. dhe V. B. të përfaqësuar nga prindi F. B., Xh. B. dhe A. B., të gjithë nga K., rr. “D. B.”, nr. .. Në pikën II (dy) të dispozitivit është detyruar e paditura Korporata Energjetike e Kosovës në Prishtinë (KEK), Sh.a Prishtinë, rr. “Nëna Terezë”, që paditësve në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material, për lëndimet e pësura të paditësit T. B. me datë 05.06.2014, për shkak të eksplozimit të rezervuarve të hidrogjenit (H2) në Departamentin TC “Kosova –A”, për 100 % të përgjegjësisë t’ia paguajë shumat e specifikuar si më poshtë: Në emër të dëmi jo material: Kompensim në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë, të intensitetit të rënd, të mesëm dhe të ultë, shumën 15,000 €, kompensim në emër të frikës së përjetuar në shumën prej 13,000 €, kompensim në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën 32,822 €, kompensim në emër të shëmtimit në shumë prej 18,000 €. Në emër të dëmit material: Kompensimi në emër të fitimit të humbur (Renta mujore) për periudhën e kaluar prej datës 05.06.2014 e deri me datë 30.04.2020 shumën prej 14,478.00 €, ndërsa duke filluar nga data 01.05.2020 e tutje deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, t’ia paguaj shumë mujore nga 150.70 €, me së largu deri me datë 10 të muajit vijues për secilin këst mujor të arritur për pagesë, kompensim në emër të ndihmës dhe përkujdesjes së personit të huaj, shumën 1,200 €, kompensim në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 1,200 €, Në emër të shpenzimeve materiale gjatë kohës së shërimit shumën prej 11,775 €. Në emër të dëmit jo material për dhimbjet shpirtërore të përjetuara për shkak të lëndimit të bashkëshortit, babait dhe të birit të tyre: F. B. (bashkëshorte) për dhimbje shpirtërore, për shkak të lëndimeve të bashkëshortit shumën prej 5,500 €, A. B. (djali) për dhimbje shpirtërore, për shkak të lëndimeve të babait shumën prej 4,500 €, E. B. (djali) për dhimbje shpirtërore, për shkak të lëndimeve të babait shumën prej 4,500 €, V. B. (vajza) për dhimbje shpirtërore, për shkak të lëndimeve të babait shumën prej 4,500 €, Xh. B. (Babai) për dhimbje shpirtërore, për shkak të lëndimeve të birit shumën prej 4,000 €, A. B. (nëna për dhimbje shpirtërore, për shkak të lëndimeve të birit shumën prej 4,000 €. Në pikën III (tre) të dispozitivit e ka detyruar të paditurën që paditësve për pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë t’ia paguajë edhe kamatën, në lartësinë prej 8%, duke filluar nga data 21.10.2020, dita kur është nxjerr aktgjykimi e deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 6,725.00 €, e të gjitha në afat prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit ligjor. Në pikën IV (katër) të dispozitivit e ka refuzuar pjesën e kërkesëpadisë përtej shumave të gjykuara nga pika një e dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë: për paditësin T. B., në emër të kompensimit për dhimbjet fizike shumën prej 7,000.00 €, në emër të kompensimit për frikë shumën prej 6.000.00 €, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën 20,000.00 €, në emër të kompensimit, për paditësen F. B., për dhimbje shpirtërore, për shkak të lëndimeve të bashkëshortit shumën prej 4,500.00 €, për paditësin A. B., për dhimbje shpirtërore, për shkak të lëndimeve të babait shumën prej 4,500.00

€, për paditësin E. B. për dhimbje shpirtërore, për shkak të lëndimeve të babait shumë prej 4,5000.00 €, për paditësen V. B., për dhimbje shpirtërore, për shkak të lëndimeve të babait shumë prej 4,500.00 €, për paditësin Xh. B., për dhimbje shpirtërore, për shkak të lëndimeve të birit shumë prej 6,000.00 €, për paditësen A. B. për dhimbje shpirtërore, për shkak të lëndimeve të birit shumë prej 6,000.00 €, si të pabazuar. Në pikën V (pesë) të dispozitivit ka vendosur që konstatohet e tërhequr padia e paditësve: T. B., F. B. dhe të miturit A., E. dhe V. (T.) B. të përfaqësuar nga prindi F. B., Xh. B., dhe A. B. të gjithë nga K., rr. "D. B.", nr., ndaj të padituirës së dytë NPTSH Buebari Comerc – Petrol me numër të biznesit ..., me pronar N. G., që të dy nga K.

Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesave të palëve ndërgjyqëse, me aktgjykimin Ac.nr.211/21, të datës 12.02.2024, në pikën I të dispozitivit ka vendosur që të aprovoj pjesërisht të themeltë ankesën e të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Sh.a., në Prishtinë, dhe ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.3043/2014, i datës 21.10.2020 në pikën II (dy) të dispozitivit të tij, në pjesën që ka bërë me kompensimin e dëmit jo material për paditësin T. B. në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike, frikës së përjetuar, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtimit, si dhe në pjesën që ka bërë me kompensimin e dëmit jo material për paditësit F. B., A. B., E. B. dhe V. B., për dhimbjet shpirtërore të përjetuara për shkak të lëndimeve të pësura të bashkëshortit dhe babait të tyre, për shkak të eksplozimit të rezervuarëve të hidrogjenit (H2) në Departamentin TC "Kosova-A", me datën 05.06.2014, për 100 % të përgjegjësisë dhe çështja gjykohet si në vijim: Detyrohet e paditura Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Sh.a., në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit jo material si pasojë e lëndimeve të pasuara për shkak të eksplozimit të rezervuarëve të hidrogjenit (H2) në Departamentin TC "Kosova - A", të ndodhur me datën 05.06.2014, për 100 % të përgjegjësisë që paditësit T. B. nga K., t'ia kompensoj dëmin jomaterial *për dhimbjet e përjetuara fizike shumë prej 14,000.00 €, për frikën e përjetuar shumë prej 10,000.00 €, për dhimbjet shpirtërore në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 25,000.00 € dhe për shëmtim në shkallë të rëndë shumë prej 10,000.00 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur atë nga dita e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë - 21.10.2020, e deri në pagesën definitive, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit. Refuzohet kërkesëpapia e paditësit T. B. nga K. për kompensimin e dëmit jomaterial në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike, në emër të frikës së përjetuar, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtimit përtej shumës së aprovuar si më lartë e deri te shuma e kërkuara, si e pabazuar. Detyrohet e paditura Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), sh.a. - Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit jo material *për dhimbjet shpirtërore të përjetuara për shkak të invailiditetit tejet të rëndë të bashkëshortit T. B.: paditëses F. B. (bashkëshortes) t'ia kompensoj shumë prej 4,000.00 €, paditësit Amar Bela - (djali) t'ia kompensoj shumë prej 4,000.00 €, E. B. (djali) t'ia kompensoj shumë prej 4,000.00 €, dhe V. B. (vajza) t'ia kompensoj shumë prej 4,000.00 € euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur atë nga dita e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë me 21.10.2020, e deri në pagesën definitive, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit. Refuzohet kërkesëpapia e paditësve F. B., A. B., E. B. dhe V. B., për kompensimin e dëmit jomaterial për dhimbjet shpirtërore të përjetuara për shkak të lëndimit të bashkëshortit**

dhe babait të tyre, përtej shumës së aprovuar si më lartë e deri te shuma e kërkuara, si e pabazuar. Në pikën II të dispozitivit është refuzuar e pathemeltë ankesa e paditësve T. B., F. B., A. B., E. B., V. B., Xh. Ba dhe A. B. nga K. dhe pjesërisht ankesa e të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Sh.a., në Prishtinë, ndërsa shumat e aprovuara të kërkesëpadisë së paditësit T. B., në pikën II (dy) të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3043/2014, të datës 21.10.2020, në pjesën që ka të bëjë me kompensimin e dëmit material *në emër të fitimit të humbur (rentës mujore) për periudhën e kaluar prej datës 05.06.2014 e deri me datë 30.04.2020, si dhe nga data 01.05.2020 e tutje, deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, në emër të ndihmës dhe përkujdesjes së personit tjetër, në emër të ushqimit të përforcuar dhe për shpenzime mjekësore gjatë kohës së shërimit*, si dhe shumat e aprovuara të kërkesëpadisë së paditësve Xh. B. dhe A. B., në pjesën që ka të bëjë me kompensimin e dëmit jo material *për dhimbjet shpirtërore të përjetuara për shkak të lëndimit të birit tyre*, në pikën III (tre) të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.3043/2014, të datës 21.10.2020, në pjesën që ka të bëjë me *shpenzimet e procedurës*, vërtetohet. Në pikën III të dispozitivit është vendosur që pika V (pesë) e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3043/2014, i datës 21.10.2020, mbetet i pashqyrtuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, brenda afatit ligjor, revizion ka paraqitur e paditura Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Sh.a, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovoj revizionin, aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta ti ndryshoj, duke refuzuar kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar.

Paditësit nuk kanë paraqitur përgjigje në revizionin e të paditurës.

Revizion kanë ushtruar edhe paditësit përmes të autorizuarit të tyre, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të ndryshoj aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta, ashtu që të miratojë kërkesëpadinë sipas precizimit të kërkesëpadisë.

Pala e paditur nuk ka paraqitur përgjigje në revizionin e paditësve.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215, gjeti se:

Revizioni i të paditurës është pjesërisht i themeltë.

Revizioni i paditësve është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se fillimisht paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datën 07.11.2014, në gjykatën e shkallës së parë, ka ushtruar padi kundër të paditurës për kompensim dëmi material dhe jomaterial, ndërsa në seancën e datës 11.06.2018, e ka bërë zgjerimin e padisë në kuptimin subjektiv, duke shtuar si paditës edhe prindërit, bashkëshorten dhe fëmijët e paditësit, ndërsa edhe përmes parashtrësës së datës 29.06.2018 është bërë rregullimi dhe zgjerimi i padisë në kuptimin subjektiv duke shtuar si të paditur të dytë edhe NPTPSH Buebari Commer-

Petrol, me pronar N. G., Kurse lartësinë e kërkesëpadisë e ka precizuar me anë të parashtresës së datës 17.06.2020, me të cilën ka kërkuar nga gjykata e shkallës së parë që kërkesëpadia e paditësve të aprovohet në tërësi si e bazuar, ashtu që e paditura KEK t'iu kompensoj dëmin paditësve në shumën e përgjithshme 197,472 €, duke përfshirë edhe shpenzimet e procedurës. Lidhur me të paditurën e dytë, pala paditëse në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 21.10.2020, e ka tërhequr padinë ndaj saj.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve, ka zhvilluar procedurën gjyqësore dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.3043/2014, të datës 21.10.2020, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të tij. Në arsytim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë mes tjerash ka theksuar se për vërtetimin e bazës juridike të kërkesëpadisë së paditësve është bazuar në provat e nxjerra dhe administruara në këtë rast me të cilat argumentohet qartë baza e kërkesëpadisë. Më tej ka arsyetuar se për të konstatuar rrethanat dhe shkaqet që kanë sjell deri të lëndimi i paditësit në vendin e tij të punës, ka angazhuar ekspertin për mbrojtje dhe sigurinë në punë, Dr.ing.Hamid Nuredini, për të vërtetuar lëndimet e paditësit është nxjerrë ekspertiza mjekësore nga Dr.Bujar Kastrati - neurokirurg, Dr.Avni Fetahu - urolog, Dr.Violeta Zatriqi - kirurge e kirurgjisë plastike dhe Dr.Nazmije Musliu - psikiatër, të cilët kanë ardhur në përfundim se natyra e lëndimeve që ka pësuar paditësi si pasojë e aksidentit, kualifikohen si lëndime të rënda trupore, duke përjetuar dhimbje fizike, frikë, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallën 48.02 %, shëmtim trupor në shkallë të rëndë, pastaj ka pasur nevojë për përkujdesje nga personi tjetër, për ushqim të përforcuar dhe rehabilitim fizioterapeutik. Për ta vlerësuar fitimin e humbur (rentës mujore) për shkak të zvogëlimit të aftësisë punuese, gjykata ka caktuar ekspertin nga lëmia e mjekësisë së punës Dr. Ali Hajra, kurse për të vërtetuar lartësinë e kërkesës që i adresohet kompensimit për fitimin e humbur (rentën), për paditësin T. B., është nxjerrë ekspertiza financiare - aktuaristikës, e ekspertit Aziz Berisha. Lidhur me bazën ligjore, gjykata e shkallës së parë ka vendosur duke u mbështetur në nenet 152.1, 154 dhe 183 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (04/L-077). Ndërsa sa i përket kërkesëpadisë së familjarëve të paditësit, paditësve F. B.-bashkëshortja, A. B., E. B. dhe V. B. - fëmijët, Xh. dhe A. B. - prindërit, për dhimbjet shpirtërore që i kanë pësuar nga lëndimi i anëtarit të familjes, ka vendosur në kuptim të nenit 184 par. 3 të LMD-së dhe ekspertizës së ekspertes Dr. Nazmije Musliu – psikiatër. Vendimin lidhur me kumatën e ka bazuar në nenin 382 të LMD-së. Vendimin për shpenzimet e procedurës e ka bazuar në nenit 449 dhe 452 të LPK-së. Ndërsa lidhur me kërkesëpadinë e paditësve ndaj të paditurës së dytë NPTSH Buebari Comerc - Petrol, me numër të biznesit ..., me pronar N. G., është vendosur që të konstatohet e tërhequr, ngase i autorizuari i paditësve në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 21.10.2020 e ka tërhequr padinë ndaj saj, duke iu referuar nenit 261 të LPK-së.

Gjykata e Apelit të Kosovës në procedurën e vendosjes sipas ankesave të palëve ndërgjyqëse, ka vlerësuar se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) i LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, por gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale kur ka gjykuar lartësinë e kërkesëpadisë në emër të dëmit jo material për paditësin T. B., në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike, në

emër të frikës së përjetuar, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtimit, si dhe në pjesën që ka bërë me kompensimin e dëmit jo material për paditësit F. B., A. B., E. B., V. B., për dhimbjet shpirtërore të përjetuara për shkak të lëndimeve të pësuar të bashkëshortit dhe babait të tyre, për çka u deshtë që aktgjykimi i atakuar në fjalë të ndryshohet dhe të vendoset si në dispozitiv të këtij aktgjykimi të gjykatës së shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit në pjesën arsyetuese ka theksuar se aktgjykimi i shkallës së parë nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike, si dhe e drejta materiale është aplikuar drejtë. Më tej në arsyetim të aktgjykimit ka theksuar se i kanë rezultuar si të pa bazuara pretendimet ankimore të paditurës për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor. Lidhur me vërtetimin e bazës juridike të kërkesëpadisë, kjo gjykatë ka pranuar qëndrimin e shkallës së parë duke vlerësuar se, një bazë e tillë, është vërtetuar në bazë të provave adekuate, konkretisht, ekspertizës së mbrojtjes dhe sigurisë në punë, ekspertizë kjo e fushës përkatëse për konstatimin e përgjegjësisë, e cila gjendet në shkresat e lëndës dhe e cila është sqaruar siç duhet edhe në pjesën arsyetuese të aktgjykimit të atakuar, sa i përket përfundimit të nxjerrë lidhur me përgjegjësinë e të paditurës. E njëjta është caktuar në pajtim me dispozitat e nenit 356 (e më tutje) të LPK-së dhe të thënat në të janë marrë si të besueshme dhe profesionale, e cila ka konstatuar përgjegjësinë e të paditurës për shkaktimin e aksidentit të ndodhur, e për të cilën e paditura ka pasur vërejtje mirëpo nuk ka propozuar nxjerrjen e ndonjë ekspertize tjetër apo grupit të ekspertëve në njërën anë dhe në anën tjetër nuk ka ofruar prova të cilat kontestojnë apo heqin përgjegjësinë e saj.

Gjykata e Apelit ka theksuar se gjendjen faktike për dëmin jo material gjykata e shkallës së parë e ka provuar përmes ekspertizës së ekspertive mjekësor Dr.Bujar Kastrati - neurokirurg, Dr.Avni Fetahu - urolog, Dr.Violeta Zatriqi - kirurge e kirurgjisë plastike dhe Dr. Nazmije Musliu - psikiatër, në bazë të cilës është sqaruar se paditësi nga eksplozimi i rezervuarit të hidrogjenit ka pësuar lëndime të rënda trupore, edhe nga kjo gjykatë, mendimet e ekspertëve janë vlerësuar si profesionale, gjithëpërfshirëse dhe reale, duke pas parasysh natyrën e lëndimit, kohëzgjatjen e dhimbjeve si dhe frikës, faktin se paditësi në cilësi të punëtorit në momentin e aksidentit ishte duke punuar në vendin e tij të punës, se kompensimi i dëmit jo-material dhe material në të holla ka për qëllim satisfaksionin për të dëmtuarin dhe jo që të arrihet ndonjë qëllim tjetër shoqëror i këtij kompensimi, duke marrë parasysh edhe zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë 48.02 %. Kjo gjykatë ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë, ka dhënë shpjegimet e duhura në arsyetim të aktgjykimit, për shumat e gjykuara sipas kategorive të dëmit si përfundim e ka marrë për bazë mendimin e ekspertëve mjekësor, prandaj në këtë kontekst edhe Gjykata e Apelit i ka pranuar vlerësimet e gjykatës së shkallës së parë, mirëpo ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale vetëm në pjesën për shumën e gjykuar për kompensimin e dëmit jo material në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike, frikës së përjetuar, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtimit për paditësin T. B., respektivisht gabimisht e ka aplikuar dispozitën e nenit 183 të LMD, kur ka gjykuar shumat për këtë kategori të dëmit, pasi që shumat është e lartë, përkundër lëndimeve të rënda që ka pësuar paditësi, nuk i shkon përshtati synimeve dhe qëllimeve shoqërore për kompensimin e dëmit, prandaj në këtë drejtim gjykata e shkallës së dytë e aprovoi

pjesërisht ankesën e të paditurës, e ndryshoi aktgjykimin e atakuar në pikën II, (sa i përket kategorive të lartcekura të dëmit) të tij dhe gjykoi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se shumata e aprovuar nga gjykata e shkallës së parë për formën e kompensimit të dëmit jo material për në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike, në emër të frikës së përjetuar, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtimit për paditësin T. B., si dhe për dhimbjet shpirtërore të përjetuara për shkak të lëndimeve të pësuar të bashkëshortit dhe babait të tyre për paditësit F. B., A. B., E. B. dhe V. B., nuk bazohen në kriteret e zbatueshme për vlerësim, e as në praktikën gjyqësore të krijuar nga Gjykatat e Kosovës për këto forma të shpërblimit të dëmit. Prandaj, gjykata e shkallës së dytë, ka aprovuar pjesërisht ankesën e të paditurës, duke e ndryshuar aktgjykimin e atakuar në pjesët e gjykuara si më sipër dhe gjykon si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se tani shumata e gjykuara si më lartë, janë adekuate dhe në përputhje me kriteret dhe qëllimin e përcaktuar me nenin 183 të LMD-së. Gjykata e Apelit gjatë vlerësimit të lartësisë së kompensimit të dëmit jomaterial për paditësin T. B., mori parasysh të gjitha kriteret të cilat shërbejnë për përcaktimin e lartësisë së shpërblimit (satisfaksioni) të dëmit jo material në emër të dhimbjeve fizike për shkak të lëndimeve të rënda të paditësit, frikës, duke pas parasysh intensitetin, kohëzgjatjen e dhimbjeve, moshën e paditësit, shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, pasojave jetësore - kufizimeve në aktivitetin jetësor, pasojat në të ardhmen, moshës, intensitetin dhe kohëzgjatjen e pasojave, vështirësitë që ka përjetuar gjatë trajtimit mjekësor në raste të tilla, pastaj shkallën e shëmtimit, duke marrë për bazë dispozitat ligjore në fuqi por edhe në bazë të praktikës gjyqësore dhe brenda shumave orientuese të vendosura nga Gjykata Supreme e Kosovës lidhur me këto kategori të dëmit jomaterial, andaj edhe erdhi në përfundim se shumata e caktuara tani sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, janë shumata që i përgjigjen kompensimit real në rastin konkret.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar të pabazuara edhe pretendimet ankimore të paditurës lidhur me mungesën e legjitimitetit real pasiv pasi që gjykata e shkallës së parë për të konstatuar rrethanat dhe shkaqet që kanë sjellë deri të lëndimi i paditësit në vendin e tij të punës, ka nxjerrë ekspertizë nga lëmia e mbrojtjes dhe sigurisë në punë, e cila ka konstatuar se në bazë të dokumentacionit në dispozicion, vizitës në vendin e ngjarjes dhe përshkrimeve të bëra, ka konstatuar se shkak për lëndimin e paditësit T. B., ka qenë eksplozimi i rezervuarve të Hidrogjenit (H₂) në TC (Kosova-A) si teknologji e KEK-ut. Një ekspertizë e tillë, kësaj gjykate i rezulton se është përpiluar duke marr parasysh edhe kushtet e Kontratën publike kornizë, me nr. prokurimit “KEKO 11 295 111, si dhe dokumentacioni dhe përshkrimet e tjera në ekspertizën në fjalë, ku është nxjerrë përfundimi se përgjegjëse për lëndimet e paditësit nga eksplozimi i datës 05.06.2014 me 100 % të përgjegjësisë është e paditura KEK-sh.a, - Prishtinë, ndërsa pretendimin lidhur me parashkrimin e kërkesës për kompensimin e paditësit për rentë e ka vlerësuar të paqëndrueshëm, kjo për faktin se e njëjta kërkesë është parashtruar me rastin e parashtrimit të padisë, mirëpo e njëjta është precizuar me rastin e marrjes së mendimit të ekspertit përkatës. Më tej gjykata e shkallës së dytë e ka vërtetuar edhe vendimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me shpenzimet procedurale, duke vlerësuar se i njëjti është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së. Për kamatën gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur dhe në pajtim me dispozitat e nenit 382 të LMD-së e cila është llogaritur në pajtim edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës për kamatën.

Ndërsa në lidhje me pikën V të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, në të cilën gjykata e shkallës së parë ka konstatuar tërheqjen e padisë së paditësit ndaj të paditurës së dytë, Gjykata e Apelit vlerëson se meqë kundër kësaj pike të aktgjykimit nuk është e lejuar ankesa, e ka konstatuar si pikë të pashqyrtuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e dhënë në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimi i kundërshtuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare, përveç pjesës së ndryshuar sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për të cilën kjo gjykatë ka ardhur në përfundim se me rastin e vendosjes është zbatuar gabimisht e drejta materiale nga gjykatat e instancës më të ulët.

Përkundër faktit se pala e paditur, përkatësisht i autorizuari i saj në revizion e paraqitur është thirrur në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, mirëpo shprehimisht nuk ka përmendur asnjë shkelje dhe nuk ka dhënë asnjë arsye, rreth shkeljeve të pretenduara të dispozitave të LPK-së. Si rezultat i kësaj, kjo gjykatë ka trajtuar aktgjykimin e shkallës së dytë vetëm në aspektin e ekzistimit të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Si rrjedhojë, sipas Gjykatës Supreme aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje esenciale nga neni 215 të LPK-së, për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Supreme e Kosovës, e pranon qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë, për pjesën tjetër të dispozitivit të aktgjykimit, duke vlerësuar se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, në përputhje me gjendjen faktike të provuar, duke e detyruar të paditurën që paditësit T. B., ti kompensoj shumat e gjykuara si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së dytë për kompensimin e dëmit jo material në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shëmtimit, si dhe kompensimin e dëmit material në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm punues, ndihmë personit të tretë, ushqim të përforcuar dhe për shpenzime të mjekimit. Përveç kësaj, kjo gjykatë ka pranuar qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit, sa i përket shumave të gjykuara në emër të kompensimit të dëmit jo material për paditësit F. B., A. B., E. B., dhe V. B., Xh. B. dhe A. B., për dhimbjet shpirtërore të përjetuara për shkak të lëndimeve të pësura të bashkëshortit, babait dhe birit të tyre. Në anën tjetër, nuk është pranuar qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së dytë për shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit jo material për dhimbje fizike dhe për frikën e përjetuar nga paditësi T. B., si rezultat i së cilës për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale në këtë pikë është ndryshuar aktgjykimi i shkallës së dytë, sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata Supreme e Kosovës, e pranon qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë, pasi ka vlerësuar se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, në përputhje me gjendjen faktike të provuar, duke lënë në fuqi pikën I, të dispozitivit lidhur me vendosjen për dëmin jo material për dhimbjet shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe për shëmtim. Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme ka refuzuar në tërësi revizionin e paditësve, ndërsa ka refuzuar pjesërisht revizionin e të paditurës dhe kërkesat e tyre

për ndryshimin e aktgjykimit të shkallës së dytë dhe të parë, për dëmin jo material si në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, në drejtim të rritjes së shumave të gjykuara, me pretendim nga paditësit se shumatat e gjykuara janë shumë të ulëta, respektivisht në drejtim të uljes së shumave të gjykuara, me pretendim nga e paditura se shumatat e gjykuara janë tejet të larta krahas lëndimeve që ka pësuar paditësi, por të njëjtat pretendime janë të pa bazuara. Kjo për faktin se aplikimi i dispozitave materialo-juridike, të cilave iu është referuar gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë, është në përputhje me gjendjen faktike, duke marrë në konsideratë natyrën e lëndimeve dhe shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shkallën e rëndë të shëmtimit, si dhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit, siç janë moshë relativisht e re e paditësit (34 vjeçar në momentin e shkakimit të aksidentit) dhe praktika gjyqësore për raste të tilla. Kjo gjykatë vlerëson se shumatat e gjykuara nga gjykata e shkallës së dytë në emër të dëmit jo material për paditësin janë shuma që i përgjigjen qëllimit të kompensimit të dëmit në rastin konkret. Nga arsyet që janë dhënë në lidhje me shumatat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit jo material për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor i përcaktuar nga ekspertiza mjekësore në shkallë prej 48.02 % dhe shëmtimit në shkallë të rëndë, rezulton se gjykata e shkallës së dytë ka pasur në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimin të cilit i shërben ky kompensim, duke u kujdesur që kompensimi t'i përputhet qëllimeve që synohen me kompensimin e dëmit jo material e që është satisfaksion për të dëmtuarin. Vlerësohet se gjykata e shkallës së dytë për format e dëmit jo material të lartcekur, ka vendosur në mënyrë të ekuilibruar në mes të shumave të gjykuara dhe natyrës së lëndimeve përkatësisht dëmeve që ka pësuar paditësi T. B., duke siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për paditësin dhe duke shmangur qëllimet tjera materiale që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfaksionit në raste të tilla, si dhe janë në përputhje me dispozitat materiale, përkatësisht nenin 183 të LMD-së.

Në anën tjetër, vlerësohen të pabazuara pretendimet e revizionit të paditurës lidhur me bazën juridike dhe lartësinë e gjykuar për paditësin në emër të dëmit material për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm punues, ushqimit të përforcuar dhe shpenzimeve tjera të shërimit. Në lidhje me këtë, rezulton se gjykatat e instancave më të ulëta drejtë kanë zbatuar të drejtën materiale me rastin e vendosjes së këtyre kategorive të dëmit material, pasi që është provuar fakti nga ekspertizat mjekësore, përfshirë këtu ekspertizën e lëmisë së punës, ndërsa lartësia është provuar përmes ekspertizës së aktuaristikës, se paditësi si pasojë e aksidentit ka pësuar edhe zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm punues me karakter të përhershëm në shkallë prej 50 %, për çka edhe me të drejtë i është gjykuar shuma sikurse në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë e të vërtetuar edhe me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, deri në arritjen e moshës së pensionimit të paditësit, e drejtë kjo e cila paditësit në këtë rast i garantohet nga dispozita e nenit 179 paragraf 2 të LMD-së. Ndërsa për ndihmë të personit të drejtë dhe për ushqimin e përforcuar me të drejtë është bazuar në ekspertizën mjekësore, ku është konstatuar periodha dhe nevoja për ndihmë të personit të tretë dhe ushqim të përforcuar, e cila është gjykuar edhe në përputhje me praktikën gjyqësore. Gjithashtu edhe shuma e gjykuar në emër të dëmit material për shpenzime të shërimit është gjykuar në bazë të provave materiale (faturat) të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në përputhje me nenin 179 paragraf 1 të LMD-së. Si rrjedhojë, Gjykata Supreme vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke refuzuar pjesërisht revizionit e të paditurës dhe në tërësi revizionin e paditësve, në lidhje me

zbatimin e të drejtës materiale për gjykimin e lartësisë së kërkesëpadisë së paditësit në emër të kompensimit të dëmit jo material për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtimin trupor, si dhe në emër të dëmit material për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm punues, ushqim të përforcuar, ndihmë për kujdes të personit të tretë dhe për shpenzime tjera të mjekimit.

Gjykata Supreme duke marrë për bazë pretendimet në revizionet e palëve ndërgjyqëse, por edhe vlerësimin sipas detyrës zyrtare për zbatimin e të drejtës materiale, vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.211/21, të datës 12.02.2024, në pikën I të dispozitivit, për paditësin T. B., lidhur kompensimin e dëmit jo material në emër të dhimbjeve fizike dhe frikës. Si rrjedhojë, ka rezultuar se shumata e gjykuara nga gjykata e shkallës së dytë për kompensim të dëmit jo material në emër të dhimbjeve fizike dhe frikës së përjetuar, janë të larta në raport me natyrën e lëndimit, pasojat, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike dhe frikës, të cilat janë përshkruar saktësisht në ekspertizën mjekësore, të përjetuara nga paditësi si pasojë e aksidentit të ndodhur. Shuma e gjykuar për këto kategori të dëmit jo material nuk i përgjigjet natyrës së lëndimit dhe pasojës dhe praktikës gjyqësore për raste të tilla, andaj kjo gjykatë vendosi që në emër të dhimbjeve fizike, e paditura t'ia paguaj paditësit shumën prej 7000,00 €, si dhe në emër të frikës, t'ia paguaj shumën prej 7.000,00 €. Në lidhje me këtë, është vlerësim i kësaj gjykate se vendosja në këtë mënyrë është vendosje e ekuilibruar në mes të shumave të gjykuara dhe natyrës së lëndimeve përkatësisht dëmeve që ka pësuar paditësi, duke siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për paditësin, duke shmangur qëllime tjera materiale që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfaksionit në raste të tilla, në përputhje me nenin 183 të LMD-së.

Gjykata Supreme ka vlerësuar edhe pretendimet e palës së paditur në revizionin e paraqitur, në lidhje me parashkrimin e kërkesës së paditësve F. B., A. B., E. B. dhe V. B., Xh. B. dhe A. B., për kompensimin e dëmit jo material në emër të dhimbjeve shpirtërore të përjetuara për shkak të invaliditetit tejet të rëndë të bashkëshortit, respektivisht babait dhe birit të paditësve, bazuar në nenin 357 të LMD-së, mirëpo erdhi në përfundim se një pretendim i tillë është i pabazuar. Kjo për faktin se referuar shkresave të lëndës, rezulton se pala e paditur në institutin e parashkrimin lidhur me pjesën e kërkesëpadisë së paditësve të cekur më lartë, nuk është thirrur gjatë zhvillimit të procedurës në gjykatën e shkallës së parë, por vetëm me rastin e parashtrimit të ankesës në gjykatën e shkallës së dytë dhe revizionin e parashtruar në këtë gjykatë. Si rrjedhojë, referuar dispozitës së nenit 180 paragraf 3 të LPK-së, lidhur me nenin 227 të LPK-së, prapësimi i parashkrimit që nuk është paraqitur në gjykimin e shkallës së parë, nuk mund të paraqitet me ankesë, e rrjedhimisht as me revizionin e parashtruar në Gjykatën Supreme, për çka edhe nuk është marr parasysh një prapësim i tillë. Në anën tjetër, referuar shkresave të lëndës, rezulton se pala e paditur është thirr në institutin e parashkrimit vetëm në raport me kërkesën e paditësit T. B., për kompensimin e rentës për shkak të fitimit të humbur dhe atë në seancën e datë 20.02.2020 dhe seancën e datës 21.10.2020. Mirëpo, edhe ky pretendim nuk qëndron, pasi që referuar përmbajtjes së petitumit të kërkesëpadisë së paditësit, rezulton se ky i fundit ndër të tjera ka kërkuar edhe kompensimin e dëmit material në emër të fitimit të humbur, ndërsa me parashtruesën për precizimin e kërkesëpadisë së datës 17.06.2020, ka precizuar vetëm lartësinë e kërkesëpadisë dhe atë pas marrjes së ekspertizave përkatëse të ekspertit të lëmisë së punës dhe

ekspertit të aktuaristikës, pasi që në raste të tilla lartësia mund të përcaktohet vetëm përmes ekspertizës përkatëse.

Si rezultat i kësaj, pranohet qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së dytë në lidhje me bazën juridike dhe lartësinë e gjykuar për kompensimin e dëmit jo material në emër të dhimbjeve shpirtërore të përjetuara për shkak të invaliditetit tejet të rëndë të bashkëshortit, respektivisht babait dhe birit të paditësve F. B., A. B., E. B. dhe V. B., Xh. B. dhe A. B. Kjo për faktin se dhimbjet shpirtërore të këtyre paditësve janë konstatuar me ekspertizën mjekësore të ekspertit psikiatër, ndërsa një e drejtë e tillë i garantohet me dispozitën e nenit 184 paragraf 3 të LMD-së, i cili shprehimisht thotë: *“Në rast të invaliditetit tejet të rëndë ose shëmtimit në shkallë të lartë të ndonjë personi, gjykata mund tu caktoj bashkëshortit, fëmijëve dhe prindërve shpërblim të drejtë në të holla për dhembjet e tyre shpirtërore”*. Nga interpretimi i kësaj dispozite, rezulton se paditësve të cekur më lartë për shkak të invaliditetit tejet të rëndë dhe shëmtimit në shkallë të lartë të familjarit të tyre (në këtë rast paditësit të parë), u takon e drejta e kompensimit të dëmit jo material në emër të dhimbjeve shpirtërore të përjetuara. Në anën tjetër, shumat e gjykuara në emër të këtij lloji dëmi, nga kjo gjykatë vlerësohen se janë gjykuar në përputhje me dispozitën e nenit 183.2 të LMD-së, ku me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e këtij lloji të dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata e shkallës së dytë është kujdesur për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim.

Në anën tjetër, vlerësohen të pabazuara pretendimet e revizionit të paditurës lidhur me mungesën e legjitimitetit real pasiv të paditurës, pasi që instancat më të ulëta me të drejtë kanë vlerësuar se përmes ekspertizës nga lëmia e mbrojtjes dhe sigurisë në punë, e hartuar nga eksperti Dr.ing. Hamid Nuredini, është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit T. B., i cili është lënduar nga eksplozimi i rezervuarve të Hidrogjenit (H₂) në TC (Kosova-A) si teknologji e KEK-ut, të cilën ekspertizë edhe kjo gjykatë e vlerëson profesionale. Nga kjo ekspertizë ka rezultuar e provuar përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit paditësit, në përputhje me nenet 152.1 dhe 154 të LMD-së, ndërsa me të drejtë është vlerësuar nga gjykatat e instancës më të ulët se në rastin konkret këtu e paditura ka përgjegjësinë e plotë për kompensimin e dëmit paditësit, pasi që nuk ka rezultuar se i njëjti të ketë kontribuar në shkaktimin e shpërthimit në rezervuarët të cilët janë pronë e të paditurës. Përveç kësaj, nuk qëndrojnë pretendimet në revizionin e të paditurës që sipas saj kanë të bëjnë me përgjegjësinë e punëdhënësit të paditësit NPTSH “Buebari Comerc”, me seli në Prishtinë, për ti kompensuar dëmin paditësit në bazë të përgjegjësisë objektive, duke pasur parasysh sipas saj lëshimet e evidentuara nga ky punëdhënës në raport me paditësin, por edhe bazuar në kontratën kornizë me numër të prokurimit KEKO-11-295-111, e protokolluar me nr.4240, datë 27.06.2011. Kjo për faktin se me të drejtë kanë konstatuar gjykatat e instancës më të ulët se referuar ekspertizës së ekspertit për siguri në punë të datës 16.08.2018, por edhe sqarimeve të dhëna nga eksperti në fjalë në shqyrtimin kryesor të datës 20.02.2020, rezulton se lëndimi i paditësit ka ardhur si rezultat i shpërthimit të rezervuarit të Hidrogjenit, të cilat janë në pronësi dhe menaxhim të paditurës, ndërsa është konstatuar se këtu paditësi me asnjë veprim nuk ka kontribuar në shpërthimin e ndodhur *(ndërsa referuar shkresave të lëndës rezulton se nga ky shpërthim janë lënduar një numër i madh i personave, e jo vetëm paditësi, si dhe ka pasur edhe humbje të jetës)*. Si rezultat i kësaj, edhe me të drejtë është konstatuar nga gjykatat e instancës më të ulët se përgjegjësia në tërësi për kompensimin e

dëmit paditësit bie mbi të paditurën KEK, e jo mbi punëdhënësin e paditësit siç ka pretenduar kjo e fundit.

Gjykata Supreme i ka vlerësuar edhe pretendimet në revizion lidhur me lartësinë e gjykuar të shpenzimeve të procedurës, mirëpo ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë të pabazuara. Kjo për faktin se referuar shkresave të lëndës rezulton se me të drejtë gjykata e shkallës së dytë e ka refuzuar ankesën e të paditurës në lidhje me vendimin për shpenzimet e procedurës, pasi që të njëjtat janë gjykuar nga gjykata e shkallës së parë në përputhje me dispozitën e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, duke marr për bazë edhe suksesin e paditësit në këtë procedurë. Gjithashtu edhe vendimi mbi kamatën e gjykuar është në përputhje me dispozitën e nenit 382 të LMD-së.

Si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi është vendosur pasi që pika V e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.211/2021, të datës 12.02.2024, nuk është atakuar me revizionet e paraqitura.

Gjykata Supreme me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet tjera sipas revizioneve të paraqitura, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me nenin 222, lidhur me nenin 224 paragraf 1 të LPK, Gjykata Supreme vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË
Rev.nr.452/2024, datë 18.02.2025

Kryetari i Kolegjit- Gjyqtari

Lumni Sallauka